



Federal Ministry
for Economic Cooperation
and Development



Karl Kübel Stiftung



für Kind und Familie

Manual mbi Parandalimin e Martesave dhe Lindjeve të Hershme

Përgatitur nga:

Sulltana Aliaj

Tiranë, 2025

Hyrje:

Ky manual është një përpjekje për të hedhur dritë mbi fenomenin e martesave dhe lindjeve të hershme, duke e trajtuar atë si një problem kompleks që prek drejtpërdrejt të drejtat e fëmijëve dhe zhvillimin e tyre holistik. Martesat e hershme dhe lindjet e hershme janë jo vetëm çështje individuale, por gjithashtu pasqyrojnë dinamika sociale, kulturore dhe ekonomike që ndikojnë në jetën e shumë individëve, veçanërisht në komunitetet marginalizuara.

Një nga qëllimet kryesore të këtij manuali është të rrisë ndërgjegjësimin në shoqërinë e gjerë për këto fenomene, duke theksuar se ato nuk janë thjesht probleme personale, por sfida kolektive që kërkojnë angazhim dhe veprim të përbashkët. Duke ofruar informacion dhe rekomandime të qarta, manuali synon të ndihmojë aktorët e ndryshëm – nga institucionet shtetërore deri te organizatat joqeveritare dhe komunitetet – për të kuptuar më mirë natyrën komplekse të këtyre çështjeve dhe për të zhvilluar strategji efektive për parandalimin e tyre.

Për më tepër, ky manual do t'u japë zë dhe hapësirë historive të grupeve të marginalizuara, siç janë komunitetet rome dhe egjiptiane, të cilat shpesh lihen në harresë dhe stigmatizohen. Duke ndarë eksperiencat e tyre dhe duke promovuar një dialog konstruktiv, ne mund të kontribuojmë në krijimin e një ambienti më mbështetës dhe më inkluziv. Kjo është një mundësi për t'i dhënë fund stigmatizimit dhe për të njohur kontributin e këtyre grupeve në shoqëri.

Ky manual është një thirrje për veprim, një burim informacioni dhe një mjet për fuqizim. Ne besojmë se me angazhimin e duhur, është e mundur të krijojmë një shoqëri ku çdo fëmijë ka mundësinë për t'u arsimuar dhe zhvilluar pa pengesa si martesat dhe lindjet e hershme. Le të fillojmë këtë udhëtim së bashku, duke ndihmuar në ndërtimin e një të ardhmeje më të sigurtë për fëmijët, sot dhe nesër!

Manuali mbi Parandalimin e Martesave dhe Lindjeve të Hershme, është hartuar nga organizata Drejtësi Sociale në kuadër të projektit ``Promovimi dhe realizimi i të drejtave të romëve në Kosovë dhe Shqipëri`` implementuar me mbështetjen e Karl Kübel Stiftung für Kind und Familie (KKS) dhe Ministrisë Federale për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (BMZ). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e vetme e organizatës Drejtësi Sociale dhe nuk mund të reflektojë në asnjë mënyrë pikëpamjet e Karl Kübel Stiftung apo Ministrisë Federale për Bashkëpunim dhe Zhvillim.

Manuali është hartuar në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve (ASHDMF) dhe është miratuar po nga kjo strukturë si një material i rëndësishëm për të parandaluar dhe adresuar martesat dhe lindjet e hershme.

Kapitulli 1: MARTESAT E HERSHME DHE LINDJET E HERSHME NË SHQIPËRI

Le të shpëtojmë fëmijërinë e fëmijëve duke parandaluar martesat e fëmijëve!

Martesat e hershme, të cilat ndodhin para moshës 18 vjeç, janë një shkelje e të drejtave të fëmijëve, duke kufizuar mundësitë për zhvillim dhe të ardhme më të mirë. Kjo praktikë shpesh lidhet me presione sociale dhe ekonomike, varfërinë, mungesën e arsimimit dhe pabarazinë gjinore, dhe ka pasoja të rënda për vajzat që martohen në moshë të re, duke përfshirë rreziqe të mëdha për shëndetin e tyre, si dhe izolim social dhe varësi ekonomike. Lindjet e hershme janë një pasojë direkte e martesave të hershme, duke shkaktuar komplikime shëndetësore dhe duke krijuar cikle të varfërisë dhe pabarazisë.

Në Shqipëri, fenomeni i martesave dhe lindjeve të hershme është më i pranishëm në zonat rurale dhe në komunitetet rome dhe egjiptiane, ku traditat kulturore dhe struktura patriarkale mbështesin këto praktika. Sipas raportit të UNICEF (2023), statistikat tregojnë se rreth 12-15% e vajzave martohen para moshës 18 vjeç, dhe kjo përqindje është edhe më e lartë në komunitetet rome dhe egjiptiane. Martesat dhe lindjet e hershme janë një fenomen të ndikuar nga faktorë kulturorë, socialë dhe ekonomikë, duke pasqyruar normat patriarkale dhe traditat që favorizojnë këto praktika në disa shoqëri. Këto martesat janë shpesh të lidhura me besime të tilla si ruajtja e nderit familjar dhe siguri i stabilitetit social dhe ekonomik, veçanërisht në komunitetet e varfra. Në Shqipëri, komunitetet rome dhe egjiptiane përballen me presione të forta kulturore dhe ekonomike që shpesh i nxisin prindërit të martojnë vajzat e tyre që në moshë të re, në përpjekje për të siguruar një status të qëndrueshëm dhe për të shmangur rreziqet e mundshme sociale. Martesat e hershme në këto komunitete janë gjithashtu të lidhura me një strukturë patriarkale, ku figurat mashkullore dhe anëtarët e tjerë më të mëdhenj në moshë të familjes apo fisit janë ata që vendosin për martesën, shpesh pa konsultuar me vajzat. Kjo situatë kërkon ndërhyrje të menjëhershme për të reduktuar prevalencën e këtyre fenomeneve, përfshirë edukimin dhe ndërgjegjësimin në lidhje me rreziqet shëndetësore dhe sociale, si dhe ofrimin e mundësive arsimimi për vajzat dhe gratë e reja, për t'u dhënë mundësinë për një jetë më të pavarur dhe të barabartë.

Martesat dhe lindjet e hershme kanë pasoja të thella dhe të qëndrueshme, sidomos për vajzat e reja. Shëndeti i tyre fizik dhe mendor është i rrezikuar, pasi ato shpesh përballen me komplikacione gjatë shtatzënisë dhe lindjes, si dhe me probleme të rëndësishme emocionale, përfshirë pasiguri,

ankth dhe depresion. Vajzat që martohen herët janë gjithashtu më të ekspozuara ndaj dhunës në familje, e cila përkeqëson shëndetin e tyre mendor dhe emocional. Po ashtu, presioni social dhe familjar i bën ato të humbasin autonominë dhe mundësinë për të zhvilluar potencialin e tyre personal dhe profesional. Lindjet e hershme shpesh shkaktojnë depresion post-partum dhe ndikojnë negativisht në zhvillimin e fëmijëve, duke reduktuar mundësitë për krijimin e lidhjeve të shëndetshme mes nënës dhe foshnjës.

Nga ana tjetër, martesat e hershme kanë ndikim të drejtpërdrejtë edhe në arsimimin dhe mundësitë e punësimit. Vajzat që martohen para moshës së pjekurisë shpesh braktisin shkollën, duke humbur mundësitë për një arsimim të plotë dhe zhvillim personal. Për vajzat nga komunitetet e marginalizuara, si ato rome dhe egjiptiane, normat kulturore dhe presionet shoqërore shpesh i shtyjnë të martohen herët, duke e vështirësuar arsimimin dhe përmirësimin e kushteve të jetesës. Kjo krijon një cikël të varfërisë dhe të mungesës së mundësive, ku vajzat e martuara herët shpesh përfundojnë në punë të pasigurta dhe me paga të ulëta, duke e përjetësuar varfërinë dhe duke i kufizuar mundësitë e tyre për t'u integruar në tregun e punës dhe shoqërinë.

Nga praktika në teori

Në këtë seksion janë ndarë disa raste reale të martesave dhe lindjeve të hershme në komunitetet rome dhe egjiptiane, të cilat tregojnë ndikimet e forta negative që këto fenomene kanë në jetën e vajzave të reja. Historitë ilustronë se shumë vajza janë martuar për shkak të presioneve ekonomike, sociale dhe kulturore, pa pasur mundësi për të përfunduar arsimin dhe pa akses në shërbime të nevojshme shëndetësore, sociale dhe arsimore. Raste si ato të E.D., A.M., dhe T.L. janë shembuj të dukurive të zakonshme që çojnë në dhunë në familje, probleme shëndetësore dhe izolim të vajzave, duke e bërë të domosdoshme ndërhyrjen me mjete edukative dhe mbështetje psikosociale.

Rastet e tjera, si ai i M.M., I.J., dhe rasti i publikuar së fundi në Korçë, theksojnë pasojat e rënda të martesave të hershme dhe presionit shoqëror për të martuar vajzat e reja, duke ndikuar seriozisht në jetën e tyre dhe atë të familjeve. Ky fenomen vazhdon të jetë një problem i thellë në shoqërinë shqiptare dhe kërkon një angazhim të përbashkët të autoriteteve, organizatave dhe komunitetit për të ndërprerë këto praktika të dëmshme dhe për të siguruar mundësi më të mira për vajzat dhe djemtë që janë të prekur.

Kapitulli 2: LEGJISLACIONI DHE ROLI I INSTITUCIONEVE

A mjaftojnë vetëm ligjet e shkruara për të parandaluar martesat e hershme?...

Legjislacioni shqiptar ofron një bazë solide për mbrojtjen e fëmijëve nga martesat dhe lindjet e hershme. *Ligji Nr. 18/2017 "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve"* është një nga dokumentet kyçe që ndalon martesat e hershme, duke e përcaktuar martesën si të paligjshme për individët nën moshën 18 vjeçare. Ky ligj është në përputhje me *Konventën për të Drejtat e Fëmijëve të Kombeve të Bashkuara* dhe thekson rëndësinë e mbrojtjes nga abuzimet dhe dhuna. Një tjetër aspekt i rëndësishëm është *Kodi Civil*, i cili vendos moshën minimale për martesë në 18 vjeç, duke mbrojtur kështu individët, sidomos vajzat, nga martesat e detyruara. Megjithatë, zbatimi i këtyre ligjeve has vështirësi për shkak të mungesës së burimeve dhe njohurive në nivel lokal.

Prindërit, kujdestarët dhe institucionet duhet të punojnë së bashku për t'u siguruar që këto ligje respektohen dhe se fëmijët janë informuar mbi të drejtat e tyre. Ata duhet të jenë të vetëdijshëm për pasojat negative që sjellin martesat e hershme, si humbja e mundësive arsimore dhe rreziku i problemeve shëndetësore. Edukimi mbi të drejtat dhe procedurat për mbrojtjen e të drejtave është thelbësor për minimizimin e prevalencës së martesave të hershme. Shkollat, shërbimet sociale, dhe organizatat joqeveritare duhet të ofrojnë trajnime dhe mbështetje për komunitetet më të rrezikuara, duke promovuar mundësi arsimimi dhe fuqizimi për vajzat. Kjo qasje integruese është thelbësore për krijimin e një shoqërie ku çdo fëmijë ka mundësi të barabarta për zhvillim personal dhe ku martesat e hershme janë plotësisht të papranueshme.

Në Shqipëri, institucione dhe organizata të ndryshme janë angazhuar në parandalimin, adresimin, referimin dhe ndjekjen e rasteve të martesave të hershme, veçanërisht për vajzat dhe gratë nga komunitetet rome dhe egjiptiane. Këto ndërhyrje kanë si qëllim luftimin e pasojave shëndetësore, sociale dhe ekonomike të martesave të hershme, të cilat shpesh pengojnë vajzat të arrijnë potencialin e tyre të plotë. Institucione të rëndësishme si *Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale*, *Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës* dhe *Institucioni i Avokatit të Popullit* dhe luajnë një rol kyç në zhvillimin e politikave, organizimin e fushatave ndërgjegjësuere dhe koordinimin e përpjekjeve për të adresuar këtë çështje. Shërbimet sociale janë të rëndësishme

në identifikimin dhe referimin e rasteve në rrezik, duke ofruar mbështetje psikologjike dhe juridike.

Për të adresuar këtë fenomen në komunitetet rome dhe egjiptiane, është e nevojshme të krijohen programe edukative që marrin parasysh *kulturën dhe nevojat specifike të këtyre grupeve*. Pjesëmarrja e *liderave lokalë* dhe bashkëpunimi me organizatat joqeveritare janë të rëndësishme për ndryshimin e perceptimeve kulturore mbi martesat e hershme. Megjithatë, ka ende sfida për t'u adresuar, veçanërisht kur bëhet fjalë për traditat e thella kulturore. Një qasje gjithëpërfshirëse që bashkon institucionet shtetërore, OJQ-të dhe komunitetet lokale është thelbësore për të luftuar martesat e hershme dhe për t'i ofruar vajzave mundësi më të mira për një jetë më cilësore.

Martesat dhe lindjet e hershme janë një fenomen kompleks që kërkojnë ndërhyrje urgjente nga autoritetet qeveritare, organizatat jo-qeveritare dhe vetë komunitetet. Ndërgjegjësimi mbi pasojat negative të lidhura me martesat dhe lindjet e hershme, si dhe sfidimi i normave kulturore që mbajnë gjallë fenomenet, janë çelësi për ndryshimin. Vetëm duke punuar së bashku mund të arrihet një shoqëri ku çdo individ ka mundësi për zhvillim personal pa u detyruar nga traditat ose presionet sociale. Rritja e ndërgjegjësimit mbi martesat dhe lindjet e hershme është thelbësore për arritjen e barazisë gjinore dhe mbrojtjen e drejtat themelore njerëzore. Është koha që shoqëria shqiptare t'i japë fund këtij cikli të dhimbshëm, duke investuar në arsimimin dhe fuqizimin ekonomik të të gjithë fëmijëve!

KAPITULLI 3: HAPAT PËR PARANDALIMIN DHE ADRESIMIN E MARTESAVE DHE LINDJEVE TË HERSHME

Në Shqipëri, parandalimi i martesave të hershme duhet të marrë në konsideratë aplikimin e një qasje shumëdimensionale që përfshin institucione qeveritare, organizata joqeveritare dhe vetë komunitetin. Këto struktura kanë përgjegjësi të ndryshme për identifikimin, referimin dhe mbështetje ndaj vajzave që rrezikojnë të martohen herët.

Në këtë kapitull, kemi shpjeguar nëpërmjet skenarëve strategjitë, mënyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve me qëllim parandalimin dhe referimin e martesave/lindjeve të hershme.

 *Skenari 1: A .F jeton në një zonë të thellë rurale dhe i përket komunitetit rom. Ajo është 11 vjeç dhe prindërit po e detyrojnë që të martohet.*

Për të parandaluar martesën e hershme të A.F, një vajze 11-vjeçare nga komuniteti rom në Shqipëri, është e nevojshme që të ndërhyjnë disa institucione, përfshirë policinë, shërbimet sociale dhe organizatat joqeveritare. Ja hapat që duhet të ndiqen:

Identifikimi i rastit

- Shërbimet Sociale: Punonjësit socialë dhe/ose Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijëve (PMF) duhet të monitorojnë situatën e A.F dhe të identifikojnë shenjat që tregojnë presionin për martesë. Kjo përfshin biseda me vajzën dhe familjen për të kuptuar më mirë rrethanat kulturore. Identifikimi i rasteve mund të realizohet nëpërmjet **vizitave** pranë vendbanimeve nga përfaqësues të shërbimeve psiko-sociale apo Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijëve, që e kanë pjesë të përshkrimit të punës vizitat në familjet që përballen me vështirësi socio-ekonomike.

Gjithashtu, është e rëndësishme që të mbahet formulari i vizitës, për të ndjekur në mënyrë të detajuar rastin. Përpos identifikimit, PMF e orientojnë A.F drejt shërbimeve psikologjike dhe sociale që do ta ndihmojnë të përballojë stresin emocional dhe presionin nga familja.

- Policia: PMF kontakton direkt Policinë kur ka informacione për martesë të hershme. Edhe në skenarin e mësipërm, policia duhet të informohet menjëherë për të ndërhyrë dhe për të mbrojtur të

drejtat e A.F. Policia së bashku me strukturat sociale mund t'i njohin prindërit me sanksionet ligjore të lidhura me martesat e hershme. Ata gjithashtu duhet të ofrojnë mbështetje në rastet e dhunës në familje.

- Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës: Ne raste të veçanta, kur vlerësohet se ka vështirësi për menaxhimin e situatës dhe koordinimin e strukturave, rasti i referohet Agjencisë. Kjo strukturë koordinon rastet në nivel qendror, si dhe jep udhëzime teknike drejtuar PMF.

- Institucioni i Avokatit të Popullit: Ky institucion mund të ofrojë mbështetje ligjore dhe ndihmë në rastet kur ka shkelje të ligjit që ndalon martesat e hershme.

-Liderët Lokalë: Angazhimi i liderëve komunitarë romë është kyç për ndryshimin e perceptimeve kulturore rreth martesave të hershme. Ata mund të ndihmojnë në krijimin e një ambienti mbështetës që promovon edukimin dhe zhvillimin e vajzave. Kështu, liderat lokalë mund të përfshihen në ``biseda negociuese`` me familjen e A.F. Është shumë e rëndësishme që përpos aspekti ligjor të mërret në konsideratë edhe aspekti i traditave dhe kulturës së komunitetit, me qëllim ndërhyrjen efektive. PMF permende

-Fushata Ndërgjegjësimi: Organizatat joqeveritare mund të organizojnë fushata ndërgjegjësimi në komunitet mbi pasojat negative të martesave të hershme. Në këtë mënyrë, informacioni shkon përtej familjet së A.F. Kur i gjithë komuniteti është i informuar

Pas ndërhyrjes, Shërbimet Sociale dhe policia duhet të monitorojnë vazhdimisht situatën e A.F për t'u siguruar që ajo nuk është më nën presionin për t'u martuar. Përdorimi i kësaj qasje shumëdimensionale do t'i ofrojë A.F mbështetje gjithëpërfshirëse dhe do ta ndihmojë atë në shmangien e martesës së hershme, duke i siguruar një të ardhme më të mirë dhe më cilësore.

 *Skenari 2: T.S është një vajzë në klasën e gjashtë. Prej 2 javësh ajo nuk frekuenton shkollën. Mësuesit kane diskutuar me prindërit dhe ata i kanë thënë qe do e martojnë vajzën dhe nuk duan që të ajo të vazhdojë ciklin edukativ, por t'i përkushtohet familjes së bashkëshortit.*

Për të adresuar rastin e T.S., një vajze në klasën e 6-të që nuk frekuenton shkollën për shkak të planifikimit të martesës së saj, është e nevojshme të ndërmerren hapa të koordinuar nga

institucione të ndryshme. Këtu janë hapat që duhet të ndiqen dhe roli i institucioneve përkatëse në parandalimin e martesave të hershme.

Identifikimi i Rastit

- Shkolla duhet të identifikojë mungesën e T.S. dhe ta raportojë atë tek autoritetet përkatëse, siç është Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve pranë Shërbimeve Sociale. PMF raportojë në mënyrë periodike për rastet tek Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës.

-Konsultimi me prindërit- Stafi i shkollës duhet të organizojë një takim me prindërit për të diskutuar arsyet e braktisjes së shkollës dhe pasojat që mund të sjellë martesa e hershme. Prindërit duhet të informohen mbi ligjin shqiptar që ndalon martesat nën moshën 18 vjeçare dhe pasojat ligjore në rastet kur ndodh martesa e hershme. Gjithashtu, është e rëndësishme që prindërve t'u bëhet me dije se edhe përmbyllja e ciklit 9-vjeçarë është e detyrueshme me ligj në Shqipëri.

-Angazhimi i Shërbimeve Sociale- Shërbimi Social duhet të ofrojë mbështetje për familjen dhe të shqyrtojë situatën socio-ekonomike që mund të ketë ndikuar në vendimin për martesën. Shërbimet Sociale duhet të bashkëpunojnë ngushtësisht me ofrues të shërbimeve shëndetësore, të cilët duhet të ofrojnë informacion mbi rreziqet shëndetësore që lidhen me martesat e hershme, duke përfshirë komplikimet gjatë shtatzënisë.

-Roli i Policisë- Policia duhet të jetë në gatishmëri për t'u angazhuar në raste ku ka dyshime për abuzim ose shkelje ligjore lidhur me martesat e hershme, duke mbrojtur të drejtat e fëmijëve.

-Monitorimi i Situatës- Institucionet duhet të monitorojnë vazhdimisht situatën e T.S. dhe t'i ofrojnë asaj mbështetje psikologjike dhe arsimore.

-Angazhimi i Organizatave Joqeveritare- Bashkëpunimi me organizata joqeveritare që punojnë për parandalimin e martesave të hershme dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve është i rëndësishëm, në mënyrë që T.S dhe familja e saj të marrin mbështetje më gjithëpërfshirëse,

-Roli i Autoriteteve Lokale- Rasti i T.S duhet të shërbejë si një rast që risjell në vëmendje nevojën për ndërhyrje nga ana e autoriteteve lokale, me qëllim krijimin e politikave dhe strategjive efektive dhe kontekstuale për parandalimin e martesave të hershme.

Me qëllim adresimin efektiv të T.S. është e rëndësishme përdorimi i një qasje shumëdimensionale që angazhon shkollën, autoritetet sociale, policinë, prindërit dhe komunitetin. Çdo hap i ndërmarrë duhet të jetë në interesin më të lartë të fëmijës, duke siguruar që ajo ka mundësi të ripërfshihet sërish në shkollë, si dhe që jeton në një mjedis pa dhunë apo detyrime sociale si martesë në moshë të hershme. Angazhimi i institucioneve si Agjencia sh për Mbrojtjen e Fëmijëve, Shërbimet Sociale dhe/ose Policia janë thelbësore për parandalimin efektiv të këtyre praktikave me pasoja negative afatgjata.

Skenari 3- Një skenar real i martesës/lindjeve të hershme

Dy skenarët e mësipërm përshkruajnë strategjitë e nevojshme, me qëllim parandalimin e martesave dhe lindjeve në moshë të hershme. Por, ne jemi të vetëdijshëm që fenomenet ndodhin dhe në shumë rastet shoqëria dhe strukturat e ndryshme kanë dështuar në parandalimin e tyre.

Kështu, skenari i 3 lidhet me një rast real:

Një vajzë 14-vjeçare nga komuniteti rom solli në jetë një fëmijë në maternitetin e Korçës. Bashkëshorti i saj, një djalë 21-vjeçar, u arrestua për veprën penale të "marrëdhënieve seksuale me të mitur" pas lindjes. Ky rast ka shkaktuar një debat të gjerë mbi martesat e hershme dhe pasojat e tyre për shëndetin dhe mirëqenien e vajzave të reja.

Skenari i përshkruar më lart ka nxjerrë në pah problematikat e vazhdueshme të kësaj dukurie në Shqipëri. Ky rast kërkon një reagim të menjëhershëm dhe të koordinuar nga institucionet përkatëse për të adresuar çështjen e martesave të hershme dhe për të mbrojtur të drejtat e fëmijëve.

mungesa

Reagimi i Institucioneve

Policia - Policia duhet të vazhdojë hetimet për rastin e përshkruar dhe të sigurojë mbrojtjen e vajzës dhe fëmijës së saj. Ajo duhet të monitorojë situatën dhe të ndihmojë në parandalimin e abuzimeve të tjera, që janë të lidhura ngushtësisht me martesat e hershme.

-Shërbimet Sociale-Shërbimi Social duhet të vlerësojë situatën socio-ekonomike të familjes dhe të ofrojë ndihmë për t'u siguruar që vajza dhe fëmija e saj kanë nevojat themelore të plotësuara. Kjo përfshin ndihmën financiare, si dhe mbështetje për integrimin social.

-Ministria e Arsimit dhe Sportit- Ministria duhet të ndërmarrë masa për t'i siguruar vajzës një mundësi rikthimi në shkollë, duke ofruar programe edukative që janë të përshtatshme për situatën e saj. Kjo do ndihmojë në parandalimin e braktisjes së shkollës nga vajzat e tjera në situata të ngjashme. Në këtë rast, qëllimi primar është që fëmija të mos ndahet nga nëna dhe t'iu sigurohet mbrojtje dhe përkujdes.

- Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës: Është autoriteti përgjegjës që ka në fokus koordinimin më të mirë të rastit dhe ofrimin e mbështetjes teknike për strukturat.

-Organizatat Joqeveritare- OJQ-të që punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve dhe barazisë gjinore duhet të angazhohen për rritjen e ndërgjegjësimit mbi rreziqet e martesave të hershme, duke organizuar fushata edukative dhe informuese në komunitetet ku këto praktika janë më të zakonshme.

-Autoritetet Lokale- Autoritetet lokale duhet të krijojnë politika që ndihmojnë në parandalimin e martesave të hershme, duke promovuar arsimimin dhe fuqizimin ekonomik të vajzave dhe grave. Gjithashtu, ata duhet të asistojnë në ofrimin e shërbimeve shëndetësore të nevojshme pas lindjes dhe t'i sigurojë vajzës dhe familjes informacion mbi shëndetin seksual dhe riprodhues.

Institucionet duhet të veprojnë në mënyrë sa më urgjente dhe të koordinuar. Skenarët e mësipërm nuk janë thjesht përshkrime të një incidenti të izoluar, por një sinjal alarmi mbi nevojën për reforma më efektive që adresojnë problemin e martesave të hershme në Shqipëri. Rritja e ndërgjegjësimit, forcimi i legjislacionit dhe ofrimi i mbështetjes sociale janë thelbësore për mbrojtjen e vajzave nga pasoja negative afatgjata që sjellin këto praktika.

KAPITULLI 4: SFIDAT AKTUALE

Pavarësisht progresit, nevojat në fushën e parandalimit të martesave dhe lindjeve të hershme janë aktuale dhe emergjente për të ndërhyrë. Në këtë seksion, janë paraqitur disa prej sfidave dhe arsyeve të lidhura me martesat/lindjet e hershme që duhet të adresohen dhe të merren në konsideratë nga profesionistët të ndryshëm.

-Personalja (nuk) Mbetet Personale

Shumë individë të komunitetit rom dhe egjiptian, për shkak të rasteve mediatike dhe sanksioneve ligjore në rastet e martesave dhe lindjeve të hershme po fillojnë të përvetësojnë praktika më të fshehta. Kështu, ka një tendencë në rritje të mendësisë dhe veprimeve për kryerjen e lindjeve në kushte shtëpiake, duke rrezikuar jetën e nënëve dhe foshnjave. Kjo praktikë, e cila ka në fokus mbrojtjen dhe fshehjen e martesave dhe lindjeve të hershme nga institucionet duhet parandaluar sa më shpejt, duke qenë se kostot janë shumë të larta.

-Mungesa e Burimeve Financiare

Një nga sfidat më të mëdha që kanë hasur projektet për parandalimin e martesave të hershme dhe lindjeve të hershme është varësia nga financimi. Financimet e siguruar për këto projekte janë shpesh të pasigurta dhe mund të jenë të kufizuara në afate të shkurtra, duke rrezikuar vazhdimësinë dhe ndikimin afatgjatë të iniciativave. Pa një burim të qëndrueshëm financiar, shumë iniciativa nuk vazhdojnë, duke lënë pa mbështetje grupet e marginalizuara.

-Trajnime për Profesionistët

Një tjetër nevojë e madhe është rritja e trajnimeve për profesionistët që punojnë me fëmijët dhe adoleshentët, veçanërisht në zonat rurale dhe në komunitetet më të marginalizuara, si ato të komunitetit rom dhe egjiptian. Pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme për të trajnuar punonjësit socialë, psikologët dhe edukatorët, ka ende një mungesë të njohurive dhe aftësive për të trajtuar veçoritë kulturore dhe sociale të këtyre grupeve. Kjo e bën të vështirë për profesionistët të ofrojnë mbështetje efektive dhe të përshtatshme për vajzat dhe gratë e reja që janë në rrezik të martesave të hershme. Një trajnimi i avancuar, i fokusuar në nevojat specifike të këtyre grupeve, mund të ndihmojë përmirësimin e ndërhyrjeve dhe mbështetjes.

-Përfshirja më Aktive e Prindërve

Për shkak të rolit dhe përfshirjes së prindërve në vendimmarrjen për martesat e hershme, lind një nevojë shumë e madhe për një angazhim të prindërve në proceset edukative. Në shumë raste, prindërit nuk janë të mjaftueshëm të angazhuar në edukimin e vajzave të tyre, sidomos për çështjet e shëndetit dhe të drejtat e tyre, duke kontribuar në vazhdimin e ciklit të martesave të hershme. Për këtë arsye është e nevojshme organizimi i aktiviteteve informuese për prindërit, duke krijuar një mjedis të hapur për diskutime mbi pasojat e martesave të hershme dhe rëndësinë e edukimit.

-Nevoja për Mbështetje Psikologjike dhe Sociale

Një aspekt tjetër kritik është ofrimi i mbështetjes psikologjike dhe sociale për vajzat që janë të ekspozuara ndaj martesave të hershme ose që kanë përjetuar këtë fenomen. Ka një nevojë të madhe për krijimin e shërbimeve të integruara që ofrojnë mbështetje emocionale dhe sociale për vajzat e reja, që mund të përjetojnë trauma psikologjike dhe stres të vazhdueshëm si pasojë e martesës së hershme. Këto shërbime mund të përfshijnë mbështetje për të përballuar presionet sociale, ofrimin e mundësive për arsimim të mëtejshëm dhe asistencë në integrimin e këtyre vajzave në shoqëri.

-Nevoja për Politika më të Qarta dhe Implementim më Efektiv të Legjislacionit

Një tjetër nevojë ka të bëjë me forcimin e politikave të qarta dhe implementimin efektiv të legjislacionit që ndalon martesat e hershme. Ndërkohë që Shqipëria ka legjislacion që ndalon martesat e hershme, shpesh mungon zbatimi i tij në terren, veçanërisht në zonat rurale dhe në komunitetet që janë të marginalizuara. Angazhimi i forcave të rendit dhe autoriteteve lokale është esencial për të siguruar që ligjet të respektohen dhe që vajzat të mbrohen nga martesat e hershme dhe të dhunshme.

-Nevoja për Iniciativa të Reja që Ndihmojnë Integrimin e Komunitetit Rom në Shërbime Sociale dhe Edukative

Ka një nevojë të madhe për zhvillimin e iniciativave të reja që mundësojnë integrimin e komunitetit rom në shërbime sociale dhe edukative. Komunitetet rom shpesh hasin barriera për të përfituar nga shërbimet shëndetësore dhe edukative, duke i bërë ata më të prekshëm për martesat

e hershme. Krijimi i mundësive që ofrojnë qasje të drejtpërdrejtë dhe të përshtatshme për këtë grup mund të ndihmojë në parandalimin e martesave të hershme.

Këto nevoja mund të adresohen përmes një angazhimi të fortë të organizatave jofitimprurëse, si dhe partnerëve ndërkombëtarë, që mund të ofrojnë mbështetje financiare dhe teknike për projektet që kanë për qëllim parandalimin e martesave të hershme dhe promovimin e edukimit dhe barazisë gjinore në Shqipëri.

-Sfidimi i Normave Kulturore

Thyerja e traditave që e konsiderojnë martesën e hershme një praktikë të zakonshme në komunitetet rome dhe egjiptiane përbën një sfidë të madhe. Kjo praktikë, e rrënjësuar thellë në kulturën dhe zakonet e këtyre komuniteteve, shpesh shihet si një mënyrë për të ruajtur nderin familjar ose për të përmbushur pritshmëritë shoqërore. Megjithatë, ndikimi i saj negativ në arsimimin, zhvillimin personal dhe mirëqenien e vajzave është i pashmangshëm. Vajzat shpesh ndërpresin arsimimin, duke humbur mundësitë për një të ardhme më të mirë dhe duke u përballur me rreziqe të larta për shëndetin fizik dhe emocional. Për të kapërcyer këtë sfidë, kërkohet një ndërhyrje e kujdesshme dhe gjithëpërfshirëse që merr në konsideratë respektin për traditat kulturore me rëndësinë e promovimit të të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore. Angazhimi i liderëve komunitarë dhe ofrimi i edukimit për familjet mund të luajnë një rol të rëndësishëm në ndryshimin e perceptimeve dhe praktikave të tilla.

-Mungesa e një Mekanizmi

Një nga sfidat kryesore në adresimin e martesave dhe lindjeve të hershme është mungesa e një mekanizmi zyrtar që monitoron dhe ndjek çështjet e lidhura me martesat dhe lindjet e hershme. Pa një strukturë të dedikuar që mbledh, përpunon dhe analizon të dhënat, është e vështirë të kuptohet shkalla e fenomenit dhe të bëhen ndërhyrje të bazuara në prova. Kjo mungesë i pengon autoritetet dhe organizatat relevante të zhvillojnë politika efektive dhe të targetuara për parandalimin e martesave të hershme dhe përkrahjen e vajzave dhe familjeve të prekura.

-Mosregjistrimi i Martesave në Gjendjen Civile

Një tjetër sfidë e rëndësishme është mosregjistrimi i martesave në gjendjen civile, që e bën të vështirë monitorimin dhe ndjekjen e këtij fenomeni. Kur martesat nuk regjistrohen, vajzat e martuara nuk kanë akses në të drejtat e ligjshme që lidhen me martesën, duke përfshirë mbrojtjen ligjore, të drejtat për trashëgimi dhe përfitimet sociale. Kjo situatë ndihmon në përjetësimin e praktikave të dëmshme dhe ndalon krijimin e një sistemi të besueshëm mbrojtës që mund të mbështesë individët e prekura nga martesat e hershme.

-Mungesa e Statistikave të Sakta dhe Koherente

Mungesa e statistikave të sakta, të detajuara dhe të vazhdueshme mbi martesat e hershme në komunitetet rom dhe egjiptiane përbën një tjetër sfidë. Kjo mungesë informacioni pengon të kuptuarin dhe dokumentimin e fenomenit, duke krijuar hendek në të dhënat që janë thelbësore për hartimin e politikave dhe strategjive efektive. Për shembull, pa një pasqyrë të qartë mbi numrin e vajzave të prekura, faktorët nxitës kryesorë dhe zonat gjeografike ku këto raste janë më të përhapura, është e pamundur të përcaktohen ndërhyrjet më të përshtatshme dhe më të targetuara.

Mungesa e statistikave ndikon gjithashtu në matjen e progresit dhe vlerësimin e ndikimit të programeve ekzistuese. Institucionet shtetërore dhe organizatat joqeveritare përballen me vështirësi në përcaktimin e prioritetëve dhe ndarjen e burimeve në mungesë të të dhënave të besueshme. Për më tepër, kjo situatë forcon perceptimin e pasaktë ose të pjesshëm mbi përmasat e problemit, duke zvogëluar vëmendjen publike dhe angazhimin institucional.

Zgjidhja e kësaj sfide kërkon investime në krijimin e mekanizmave të fortë për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, përfshirjen e statistikave të detajuara në çdo fazë të analizës dhe ndërtimin e partneriteteve me aktorë lokalë për mbështetje në terren. Përfshirja e komuniteteve rom dhe egjiptiane në procesin e mbledhjes së të dhënave, si dhe sensibilizimi i tyre mbi rëndësinë e raportimit të rasteve, mund të ndihmojë në krijimin e një baze më të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse për të adresuar këtë problem.

KAPITULLI 4: SI MUND TË PARANDALOHEN MARTESAT/LINDJET E HERSHME

Në këtë kapitull do të ndahen disa strategji se si mund të parandalohen martesat e hershme, duke u bazuar në shembuj praktikë dhe qasje të testuara që promovojnë të drejtat dhe fuqizimin e vajzave dhe grave. Martesat e hershme janë një fenomen që ndikon negativisht në zhvillimin social dhe ekonomik të komuniteteve, duke u mohuar vajzave/djemve të drejtën për arsim, autonomi dhe mundësi të barabarta. Për t'i adresuar këto sfida, është thelbësore zbatimi i një kombinimi të strategjive që përfshijnë arsimimin, ndërgjegjësimin, fuqizimin ekonomik dhe angazhimin e komunitetit.

Një ndër strategjitë më të rëndësishme është **arsimimi i vajzave dhe djemve për të drejtat e njeriut dhe pasojat e martesave të hershme**. Shkollat mund të shërbejnë si një platformë për promovimin e edukimit gjithëpërfshirës, me fokus diskutime mbi barazinë gjinore, të drejtat e fëmijëve dhe ndikimet negative të martesave të hershme në jetën e individëve dhe komunitetit. Krijimi i klubeve shkollore dhe organizimi i sesioneve ndërgjegjëse mund të ndihmojnë nxënësit të zhvillojnë aftësi kritike dhe vetëdije për rëndësinë e shtyrjes së martesës deri në moshën madhore.

Angazhimi i familjeve dhe komuniteteve në procesin e ndërgjegjësimit është një tjetër hap thelbësor. Organizimi i takimeve me prindër dhe liderë komunitarë për të diskutuar pasojat e martesave të hershme, si dhe prezantimi i shembujve pozitivë të vajzave që kanë përfituar nga arsimimi dhe fuqizimi ekonomik, mund të nxisë një ndryshim kulturor. Përveç kësaj, krijimi i grupeve mbështetëse me gratë dhe vajzat në komunitet ndihmon në krijimin e një mjedisi solidar ku ato mund të ndajnë përvojat dhe të mësojnë nga njëra-tjetra.

Fuqizimi ekonomik i vajzave dhe grave përbën një element kyç në parandalimin e martesave të hershme. Përmes trajnimeve profesionale, mundësimin të qasjes në burime financiare dhe krijimit të programeve të vetëpunësimit, vajzat mund të përfitojnë pavarësi ekonomike dhe të marrin kontroll mbi vendimet që lidhen me jetën e tyre. Modele të tilla suksesi mund të jenë frymëzuese dhe të reduktojnë presionet për martesë të hershme si një zgjidhje për sfidat ekonomike të familjeve.

Promovimi i politikave dhe ligjeve që mbrojnë të drejtat e vajzave dhe ndalojnë martesat e hershme është një komponent tjetër i rëndësishëm. Advokimi për forcimin e legjislacionit ekzistues, si dhe për zbatimin e tij të rreptë, ndihmon në krijimin e një mjedisi ligjor që mbron vajzat nga ky fenomen. Në këtë kontekst, roli i organizatave joqeveritare dhe i mediave është thelbësor për të ushtruar presion publik dhe për të rritur ndërgjegjësimin për problemin.

Krijimi i programeve mbështetëse dhe të qëndrueshme për vajzat që janë të rrezikuara nga martesa e hershme është një tjetër hap i rëndësishëm. Këto programe mund të përfshijnë qendra këshillimi, trajnime për aftësi jetësore dhe mbështetje psikologjike për vajzat dhe familjet e tyre. Një shembull konkret është bashkëpunimi me shkollat dhe qendrat komunitare për të siguruar mbështetje të integruar, duke përfshirë ndihmë për të vazhduar shkollimin ose për të hyrë në tregun e punës.

Angazhimi i burrave dhe djemve si aleatë në luftën kundër martesave të hershme ka një ndikim të konsiderueshëm. Edukimi i burrave dhe djemve për barazinë gjinore dhe rolin e tyre në mbështetjen e vajzave për të ndjekur aspiratat e tyre ndihmon në krijimin e një kulture të re të respektit dhe mbështetjes reciproke.

Në përfundim, parandalimi i martesave të hershme kërkon një qasje të gjithanshme që përfshin arsimin, ndërgjegjësimin, fuqizimin ekonomik dhe forcimin e ligjeve. Duke kombinuar këto strategji me angazhimin aktiv të komuniteteve dhe mbështetjen institucionale, mund të krijojmë një mjedis ku vajzat kanë mundësi të zhvillohen plotësisht dhe të realizojnë potencialin e tyre.

KAPITULLI 5: HISTORITË DHE PRAKTIKAT POZITIVE

Historitë pozitive shërbejnë si dëshmi se ndryshimi është i mundur dhe se çdo individ ka potencialin për t'u bërë një forcë për ndryshim. Ato ofrojnë një platformë për të dhënë zë grupeve të marginalizuara, duke i lejuar ata të ndajnë eksperiencat e tyre dhe të tregojnë se si kanë sfiduar pengesat e martesave të hershme. Kjo ndihmon në rritjen e ndërgjegjësimit në shoqëri për pasojat negative të këtyre martesave, duke kontribuar në krijimin e një ambienti më mbështetës dhe më inkluziv. Për më tepër, ndarja e praktikave pozitive inkurajon angazhimin e aktorëve të ndryshëm – nga institucionet shtetërore deri te organizatat joqeveritare dhe vetë komunitetet – për të zbatuar strategji efektive që adresojnë çështjet e martesave të hershme. Ato ofrojnë mësim të vlefshme mbi atë çfarë funksionon dhe si mund të adaptohen praktikat e suksesshme në kontekste të ndryshme.

Në Shqipëri, disa histori suksesi kanë kontribuar në uljen e martesave të hershme dhe përmirësimin e kushteve të jetesës për vajzat dhe gratë. Një shembull i rëndësishëm është *përfshirja në arsim e vajzave nga komunitetet rome dhe egjiptiane*, ku krijimi i mundësive për ndjekjen e arsimit të mesëm dhe të lartë ka ndihmuar në forcimin e aftësive të tyre dhe shmangien e martesave të hershme. Gjithashtu, *grupet e mbështetjes* të ngritura nga gratë dhe vajzat kanë ofruar hapësira për sensibilizim dhe inkurajim të pjesëmarrjes në arsim dhe zhvillim ekonomik. Këto grupe kanë organizuar aktivitete për të ndërgjegjësuar komunitetet mbi pasojat e martesave të hershme dhe kanë inkurajuar vajzat të bëhen udhëheqëse të ndryshimit.

Një tjetër praktikë e suksesshme është *angazhimi i prindërve në proceset edukative* përmes programeve sensibilizuese, të cilat kanë ndihmuar në ndryshimin e mentaliteteve dhe mbështetjen e vajzave për të ndjekur shkollën dhe për të shmangur martesat e detyruara. Po ashtu, programet e ndërgjegjësimit mbi të drejtat e vajzave dhe rekomandimet për përmirësime ligjore kanë ndihmuar në rritjen e mbështetjes për arsim dhe alternativa jetese për vajzat.

Modele Pozitive nga Vende të Tjera

Në nivel ndërkombëtar, shumë iniciativa të suksesshme mund të shërbejnë si shembuj frymëzimi. Në Turqi, mbështetja ekonomike për familjet ka ndihmuar vajzat të vazhdojnë shkollimin, duke ulur normën e martesave të hershme dhe rritur pavarësinë e tyre. Në Afrikën Lindore, programet që ofrojnë arsim dhe mundësi zhvillimi profesional për vajzat kanë ndihmuar në zvogëlimin e martesave nën moshën 18 vjeç dhe kanë fuqizuar ekonomikisht vajzat përmes trajnimeve profesionale dhe ndihmës psiko-sociale.

Në Indi dhe Bangladesh, projektet për edukimin dhe fuqizimin e vajzave kanë ofruar alternativa ekonomike dhe shoqërore për vajzat, duke përfshirë fushata ndërgjegjësimi dhe zhvillim aftësish. Po ashtu, në Sudanin e Jugut, angazhimi i liderëve komunitarë dhe prindërve ka ndihmuar në ndryshimin e normave kulturore që mbështesin martesat e hershme, duke promovuar arsimimin dhe zhvillimin personal të vajzave.

Çfarë na Tregojnë Praktikët e Suksesshme?

Praktikat më të rëndësishme përfshijnë:

- arsimimin e vajzave
- mbështetje ekonomike
- angazhimin e komunitetit
- mbështetje psiko-sociale
- shërbime ligjore
- fushata të ndërgjegjësimi

Krijimi i mundësive për arsimim dhe zhvillim profesional është një hap vendimtar për të ofruar alternativa ndaj martesave të hershme. Aktivitetet që angazhojnë komunitetet dhe prindërit për të ndryshuar normat kulturore kanë treguar rezultate të mira në ndryshimin e mentalitetit dhe mbështetjen e vajzave.

Këto histori suksesi, nga Shqipëria dhe vende të tjera, tregojnë se me politikat e duhura dhe angazhimin e komunitetit, është e mundur të bëhen përpertime të rëndësishme për fuqizimin e vajzave dhe ndërtimin e një të ardhmeje më të sigurt për to.

Kapitulli 6: UDHËZIME MBI STRATEGJITË EFEKTIVE PËR PARANDALIMIN E MARTESAVE TË HERSHME

Trajtimi i martesave të hershme kërkon një qasje gjithëpërfshirëse që përfshin veprime ligjore, reforma arsimore dhe ndërhyrje të bazuara në komunitet.

Kapitulli i fundit do të fokusohet në dhënien e udhëzimeve drejtuar strukturave të ndryshme, me qëllim parandalimin dhe minimizimin e martesave dhe lindjeve të hershme. Është shumë e rëndësishme që secila nga strukturat të ndërhyjë dhe të integrojë shërbimet, duke rritur informimin dhe ndërgjegjësimin drejt krijimit të një shoqërie me fokus mbrojtjen e fëmijëve, si dhe promovimin e diversitetit dhe gjithëpërfshirjes.

➤ Udhëzime drejtuar Strukturave Shtetërore

Me qëllim minimizimin e martesave dhe lindjeve të hershme, strategjitë e mëposhtme mund të ndiqen nga Strukturat Shtetërore gjatë punës së tyre:

1. Forcimi i Legjislacionit-Rishikimi dhe forcimi i ligjeve që ndalojnë martesat nën moshën 18 vjeçare, duke përfshirë sanksione më të rrepta për ata që organizojnë ose lejojnë martesat e hershme. Kjo do të ndihmojë në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe do të krijojë një mjedis më të sigurt për ata.

2. Edukimi dhe Ndërgjegjësimi: Zhvillimi i fushatave edukative për të rritur ndërgjegjësimin mbi pasojat negative të martesave të hershme. Këto fushata duhet të përfshijnë informacione për shëndetin, arsimimin dhe zhvillimin personal të vajzave, duke angazhuar komunitetet në diskutime dhe aktivitete.

3. Përmirësimi i Qasjes në Arsim: Sigurimi i qasjes së barabartë në arsim për vajzat, duke ofruar burime financiare dhe mbështetje për familjet që mund të kenë nevojë. Kjo do të ndihmojë në uljen e normave të braktisjes së shkollës dhe do t'i japë vajzave mundësi më të mira për të ndërtuar një jetë të pavarur.

4. Angazhimi i Komunitetit: Inkurajimi i angazhimit aktiv të liderëve lokalë, prindërve dhe organizatave joqeveritare në parandalimin e martesave të hershme. Kjo përfshin krijimin e grupeve mbështetëse që promovojnë ndryshimin e normave kulturore dhe ofrojnë mbështetje për vajzat dhe familjet e tyre.

5. Programet e Mbështetjes Ekonomike: Zhvillimi i programeve që ofrojnë mbështetje ekonomike për familjet me vajza, duke i inkurajuar ato që t'i mbajnë vajzat në shkollë dhe t'i ndihmojnë ato të shmangin martesat e hershme. Kjo mund të përfshijë subvencione, bursa shkollore ose mundësi punësimi.

6. Trajnimi i Gjyqtarëve dhe Avokatëve: Ofrimi i trajnimeve për gjyqtarët dhe avokatët mbi rëndësinë e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve dhe interpretimin e ligjit në mënyrë që të ndalojnë martesat e hershme. Kjo do t'i ndihmojë ata të kuptojnë më mirë pasojat sociale dhe psikologjike që lidhen me këto raste.

7. Monitorimi dhe Raportimi: Krijimi i një mekanizmi monitorimi për të ndjekur rastet e martesave të hershme dhe për t'u siguruar që ligjet po zbatohen siç duhet. Kjo do t'i japë autoriteteve një pasqyrë më të qartë mbi situatën aktuale dhe do t'i ndihmojë ata në marrjen e masave efektive.

8. Zhvillimi i Politika Kombëtare: Hartimi i politikave kombëtare që adresojnë çështjet e martesave të hershme, duke përfshirë strategji afatgjata për edukimin, shëndetin dhe fuqizimin ekonomik të vajzave. Kjo do t'i japë një kornizë gjithëpërfshirëse veprimeve që duhen ndërmarrë.

9. Fushatat e Sensibilizimit në Komunitet: Organizimi i aktiviteteve komunitare që promovojnë diskutime mbi martesat e hershme, duke ftuar ekspertë, aktivistë dhe anëtarë të komunitetit për të ndarë eksperiencat e tyre dhe për t'u angazhuar në dialog.

10. Pjesëmarrja e Fëmijëve në Vendimmarrje: Inkurajimi i pjesëmarrjes së fëmijëve dhe adoleshentëve në proceset vendimmarrëse që ndikojnë në jetën e tyre, duke u dhënë atyre një zë në çështjet që lidhen me martesat e hershme. Kjo mund të realizohet përmes grupeve rinore ose platformave ku ata mund të shprehin mendimet dhe shqetësimet e tyre.

11. Forcimi i Rolit të Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës: Rekomandohet që Agjencia të koordinojë procesin për krijimin e kurrikulave dhe moduleve të dedikuara për rritjen e kapaciteteve të profesionistëve, si dhe të udhëheqë procesin e trajnimeve apo mentorimeve të ofruesve të shërbimeve nga fusha të ndryshme. Kurrikulat dhe aktivitetet për rritjen e kapaciteteve duhet të fokusohen në parandalimin, menaxhimin dhe adresimin efektiv të martesave dhe lindjeve të hershme, duke përfshirë qasje të bazuara në të drejtat e njeriut, ndjeshmërinë kulturore dhe ndërgjegjësimin komunitar.

➤ *Udhëzime drejtuar Shkollave*

Shkollat janë aktorë të rëndësishëm në reduktimin e niveleve të martesave dhe lindjeve të hershme. Për këtë arsye, rekomandohet që shkollat të implementojnë strategji si në vijim:

1. Zhvillimi i një programi edukativ që informon nxënësit mbi të drejtat e tyre dhe pasojat negative të martesave të hershme. Kjo mund të realizohet përmes mësimave dhe aktiviteteve interaktive që inkurajojnë diskutimin dhe reflektimin.
2. Ofrimi i trajnimeve për mësuesit mbi identifikimin e rasteve të martesave të hershme dhe mënyrat për t'i mbështetur nxënësit e prekur. Mësuesit duhet të jenë të aftë të njohin shenjat e rrezikut dhe të ofrojnë ndihmë adekuate.
3. Formimi i grupeve mbështetëse në shkolla që përfshijnë nxënës, prindër dhe mësues, për të diskutuar çështjet e martesave të hershme dhe për të ndihmuar ata që janë në rrezik. Këto grupe mund të organizojnë aktivitete sensibilizuese dhe mbështetje emocionale.
4. Organizimi i fushatave ndërgjegjëse në shkolla dhe në komunitet për të informuar rreth pasojave negative të martesave të hershme dhe rëndësisë së arsimimit për vajzat. Kjo mund të përfshijë posterë, broshura dhe aktivitete artistike.
5. Sigurimi i burimeve dhe mbështetjes për vajzat që dëshirojnë të vazhdojnë shkollimin, duke ofruar bursa ose ndihmë financiare për familjet që kanë nevojë. Kjo do t'i japë vajzave mundësi më të mira për t'u zhvilluar.
6. Angazhimi i prindërve në procesin edukativ dhe informimin e tyre mbi rreziqet e martesave të hershme. Shkollat mund të organizojnë takime me prindërit për t'i informuar ata mbi rëndësinë e arsimimit dhe pasojat e martesave para moshës së ligjshme.
7. Hartimi i politikave shkollore që ndalojnë çdo formë presioni për martesat e hershme dhe që promovojnë mbrojtjen e nxënësve nga abuzimet. Kjo do t'i japë një kornizë ligjore veprimeve brenda shkollës.

8. Zhvillimi i një sistemi monitorimi për identifikimin e rasteve të nxënësve që janë në rrezik nga martesë e hershme, duke bashkëpunuar me autoritetet lokale dhe organizatat joqeveritare për t'u siguruar që ata marrin mbështetje.

9. Angazhimi në projekte ndërkombëtare që fokusohen në parandalimin e martesave të hershme, duke ndarë praktikat më të mira dhe burimet me shkolla nga vende të tjera.

10. Ofrimi i informacionit mbi shëndetin riprodhues dhe marrëdhëniet e shëndetshme si pjesë e kurikulës shkollore, duke ndihmuar nxënësit të kuptojnë rëndësinë e pritjes deri në moshën e duhur për martesë dhe krijimin e familjes.

Këto hapa synojnë ta bëjnë shkollën një ambient mbështetës që promovon edukimin, ndërgjegjësimin dhe mbrojtjen nga martesat dhe lindjet e hershme, duke kontribuar kështu në zhvillimin social dhe ekonomik të komunitetit.

➤ *Udhëzime drejtuar ofruesve të shërbimeve shëndetësore, sociale dhe policore*

Këto struktura të rëndësishme janë kyçe për parandalimin e martesave dhe lindjeve të hershme. Për këtë arsye është e rëndësishme të ndiqen hapat e mëposhtëm:

1. Ofruesit e shërbimeve sociale, shëndetësore dhe policore duhet të krijojnë një rrjet bashkëpunimi për të ndarë informacion dhe për të koordinuar veprimet e tyre në parandalimin e martesave dhe lindjeve të hershme. Kjo do të ndihmojë në identifikimin e rasteve të rrezikshme dhe ofrimin e ndihmës së nevojshme.

2. Ofrimi i trajnimeve për stafin e shërbimeve sociale dhe shëndetësore mbi njohjen e shenjave të martesave të hershme dhe ofrimin e mbështetjes emocionale dhe ligjore. Kjo do t'i ndihmojë ata të jenë më të përgatitur për të trajtuar këto raste me ndjeshmëri dhe profesionalizëm.

3. Zhvillimi i protokolleve të qarta për veprimet që duhet të ndiqen nga ofruesit e shërbimeve në rastet e dyshuara të martesave të hershme. Këto protokolle duhet të përfshijnë hapat për raportimin, mbështetje psikologjike dhe ndihmë ligjore.

4. Organizimi i fushatave ndërgjegjësuere që informojnë komunitetet mbi pasojat negative të martesave të hershme dhe rëndësinë e mbrojtjes së fëmijëve. Kjo mund të përfshijë aktivitete në shkolla, qendra komunitare dhe media lokale.

5. Sigurimi i aksesit në shërbime psiko-sociale për vajzat dhe familjet që janë në rrezik nga martesat e hershme. Këto shërbime duhet të ofrojnë mbështetje emocionale, këshillim dhe informacione mbi mundësitë e arsimit dhe punësimit.

6. Inkurajimi i angazhimit aktiv të prindërve në procesin edukativ dhe informimin e tyre mbi rreziqet e martesave të hershme. Ofruesit e shërbimeve duhet të organizojnë takime me prindërit për t'i edukuar ata mbi rëndësinë e arsimimit dhe mbrojtjes së fëmijëve.

7. Krijimi i një mekanizmi monitorimi për ndjekjen e rasteve të vajzave që janë në rrezik nga martesa e hershme, duke bashkëpunuar me autoritetet lokale dhe organizatat joqeveritare për t'u siguruar që ata marrin mbështetje.

8. Advokimi për zhvillimin e politikave kombëtare që adresojnë çështjet e martesave të hershme, duke siguruar që ato janë në përputhje me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve.

9. Angazhimi në projekte ndërkombëtare që fokusohen në parandalimin e martesave të hershme, duke ndarë praktikat më të mira dhe burimet me ofruesit nga vende të tjera.

10. Krijimi i një sistemi raportimi dhe vlerësimi për efektivitetin e shërbimeve që ofrohen ndaj vajzave në rrezik nga martesat e hershme, duke siguruar që informacioni mblidhet dhe analizohet përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve.

Këto rekomandime synojnë ta bëjnë sistemin social, shëndetësor dhe policor më efektiv në parandalimin e martesave dhe lindjeve të hershme, duke kontribuar kështu në mbrojtjen e drejtat e fëmijëve dhe promovimin e zhvillimit social.

➤ *Strategji efektive për Punën me Komunitetin Rom dhe Egjiptian*

Puna direkte me komunitetin Rom dhe Egjiptian, si komunitetet me norma më të larta të martesave dhe lindjeve të hershme është komponenti kryesor për reduktimin e fenomenit. Për këtë arsye, sugjerojmë praktikat e mëposhtme, si baza e komunikimit dhe ndërhyrjes në komunitet. Këto rekomandime iu drejtohen të gjitha strukturave dhe autoriteve që punojnë në këtë fushë:

1. Organizoni sesione edukative për prindërit dhe fëmijët mbi rëndësinë e arsimimit dhe pasojat e martesave të hershme. Kjo mund të përfshijë fushata ndërgjegjësimi për të informuar komunitetin mbi të drejtat e fëmijëve dhe rëndësinë e arsimimit si një mjet për avancimin social.
2. Inkurajoni anëtarët e komunitetit të angazhohen në proceset vendimmarrëse që i prekin ata, duke u bërë pjesë e organizatave lokale ose grupeve të interesit që promovojnë çështjet e tyre. Kjo do t'i ndihmojë ata të kenë zë dhe të ndikojnë në politikat që i prekin.
3. Organizoni aktivitete kulturore që promovojnë traditat dhe kulturën rome dhe egjiptiane, duke ndihmuar në ruajtjen e identitetit kulturor dhe forcimin e bashkëpunimit brenda komunitetit.
4. Krijoni mekanizma mbështetjeje për nxënësit romë dhe egjiptianë që kanë vështirësi në shkollim, siç janë mentorët vullnetarë ose programet pas shkollore që ofrojnë ndihmë akademike.
5. Promovoni aksesin në shërbime shëndetësore për anëtarët e komunitetit, duke organizuar fushata për shëndetin reprodutiv dhe planifikimin familjar, si dhe ofrimin e informacionit mbi shëndetin dhe higjienën.
6. Formoni grupe mbështetjeje për gratë dhe vajzat brenda komunitetit, ku ato mund të ndajnë eksperiencat e tyre, të diskutojnë sfidat dhe të gjejnë mbështetje në rastet e martesave të hershme.
7. Angazhoni prindërit në aktivitete që promovojnë arsimimin dhe mbrojtjen e fëmijëve nga martesat e hershme, duke organizuar takime informative ku ata mund të diskutojnë shqetësimet e tyre.
8. Inkurajoni anëtarët e komunitetit të marrin pjesë në trajnime për zhvillimin personal dhe profesional, duke ndihmuar ata të fitojnë aftësi që do t'i ndihmojnë në tregun e punës.
9. Bashkëpunoni me organizatat joqeveritare që punojnë për mbështetje sociale dhe arsimore, duke u angazhuar në projekte që synojnë përmirësimin e kushteve të jetesës brenda komunitetit.

10. Angazhoni grupet lokale për të monitoruar situatën e fëmijëve brenda komunitetit, duke raportuar rastet e martesave të hershme ose abuzimeve dhe duke kërkuar ndihmë nga autoritetet kur është e nevojshme.

Zbatimi i këtyre strategjive synon fuqizimin e komunitetit rom dhe egjiptian për të parandaluar martesat dhe lindjet e hershme, duke promovuar arsimimin, shëndetin dhe angazhimin aktiv në shoqëri.

Në përmbyllje të manualit...

Ky manual është një burim i rëndësishëm për të gjithë aktorët e përfshirë në parandalimin e martesave dhe lindjeve të hershme, duke përfshirë institucionet shtetërore, organizatat joqeveritare, shkollat, ofruesit e shërbimeve sociale dhe shëndetësore, si dhe vetë komunitetet rome dhe egjiptiane. Qëllimi kryesor i këtij manuali është të ofrojë një kornizë të qartë dhe praktike për veprim, duke identifikuar rekomandime konkrete që mund të aplikohen në nivel lokal dhe kombëtar.

Rëndësia e këtij manuali qëndron në faktin se ai adreson një problem kompleks dhe shumëdimensional që prek drejtpërdrejt të drejtat e fëmijëve dhe zhvillimin social. Martesat e hershme dhe lindjet e hershme kanë pasoja të rënda, jo vetëm për individët e prekur, por edhe për shoqërinë në tërësi. Ato kontribuojnë në cikle varfërie, mungesë arsimimi dhe shëndeti të dobët, duke penguar kështu zhvillimin ekonomik dhe social të komuniteteve.

Manuali ofron një gamë të gjerë rekomandimesh që synojnë forcimin e bashkëpunimit ndërinstitutional, rritjen e ndërgjegjësimit në komunitet, mbështetje për arsimimin dhe shëndetin, si dhe angazhimin aktiv të prindërve dhe liderëve lokalë. Ai gjithashtu nxit krijimin e rrjeteve mbështetëse që ndihmojnë individët në rrezik dhe promovon politikat që mbrojnë të drejtat e fëmijëve.

Për ta përdorur këtë manual efektivisht, aktorët e ndryshëm duhet ta integrojnë atë në strategjitë e tyre ekzistuese dhe ta adaptojnë atë sipas nevojave specifike të komuniteteve me të cilat punojnë. Organizatat mund të përdorin rekomandimet për të zhvilluar programe trajnimi, fushata ndërgjegjësimi dhe politika lokale. Shkollat mund ta përdorin si një udhëzues për të krijuar ambiente mbështetëse për nxënësit, ndërsa ofruesit e shërbimeve sociale dhe shëndetësore mund ta aplikojnë për të ofruar mbështetje më efektive.

Në përfundim, ky manual është një hap i rëndësishëm drejt krijimit të një shoqërie më të drejtë dhe më të barabartë, ku çdo fëmijë ka mundësinë për t'u arsimuar dhe zhvilluar pa u përballur me pengesa si martesat dhe lindjet e hershme. Angazhimi i çdo aktori në këtë proces është thelbësor për arritjen e rezultateve pozitive dhe ndihmon në ndërtimin e një të ardhmeje më të ndritur për brezat e ardhshëm.

Referencat e Manualit:

- Child Protection (2023). Study on Early Marriages.
- Council of Europe (2020). "Improvement of Education and Protection for Girls and Boys."
- Council of Europe (2023). Child Marriage - Awareness Raising.
- FAO (2015). Gender Equality Assessment in the Country
- Free Europe (2023). The Alarming Reality of Early Marriages in Albania
- Frontiers in Global Women's Health (2022). Parents' intention toward early marriage of their adolescent girls in Eastern Ethiopia.
- Gazeta Shqip (2024) "Early Marriages in Albania: The Case of a 14-Year-Old Girl in Korça That Exposed This Phenomenon." [Link](<https://gazeta-shqip.com/aktualiteti/martesat-e-hershme-ne-shqiperi-rasti-i-14-vjecares-ne-korce-qe-nxorri-ne-pah-kete-fenomen/>).
- Girls Not Brides (2019). Mobilising families and communities to end child marriage.
- Girls Not Brides (2020). Mobilise families and communities - Girls Not Brides.
- ILO (2021). The Role of Education and Schooling in the Fight Against Early Marriages.
- INSTAT (2015). Women and Men in Albania.
- INSTAT & UNICEF (2023). Statistics on Early Marriages and Births in Albania.
- Law No. 121/2016 "On Social Services."
- Law No. 18/2017 "On the Rights and Protection of Children."
- Observatory on Children's Rights (2018). "Report on Early Marriages."
- OSF (2020). Study on Children's Rights and Situation in Albania.
- Roma Active (2023). Report on Roma Marriages.

- Saferworld (2020). Preventing a case of early marriage: the community takes action
- Save the Children Albania (2022). "Child Protection Program 2022-2024."
- Svanemyr et al., (2018). Effectiveness of a Community-Based Intervention to Delay Early Marriage. PMC.
- UNFPA (2015). Child Marriage.
- UNFPA (2022). Report on the Health of Young Mothers and the Impact of Early Births
- UNICEF (2019). Early Marriages and Their Impact on Children.
- UNICEF (2020). Early marriage and its impact on children's health and education in Albania. Retrieved from UNICEF Albania.
- UNFPA (2021). The State of World Population Report: My Body is My Own.
- UNICEF (2022). Education as a Tool for Change.
- The Civil Code of Albania (2020).
- WHO (2020). Health Consequences of Child Marriages.
- World Bank (2017). Economic Impacts of Child Marriage: Work, Earnings and Household Welfare.
- World Vision (2020). The impact of early marriage and the importance of community-led initiatives. Retrieved from World Vision website.